

FEHARI RAMADANI

**SHQIPËRIA NË POLITIKËN E AUSTRO-HUNGARISË
NË FILLIM TË SHEK.XX**

Gjatë shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, arsimit në Shqipëri u zhvillua në kushte shumë të vështira. Qëndrimi ndaj shkollës dhe arsimit shqiptar ishte i lidhur ngushtë me nivelin e zhvillimit dhe karakterin e Perandorisë Osmane. Zhvillimi ekonomik në atë perandori të prapambetur ka ecur me një dinamikë dukshëm më të ngadalshme, në krahasim me vendet e Evropës Perëndimore, të cilat kishin arritur në një shkallë shumë më të lartë të zhvillimit në përgjithësi, e në këtë kuadër edhe në sferën shoqërore.

Atdhetarët shqiptarë të periudhës së Rilindjes Kombëtare hartuan platformën politike për të luftuar për një Shqipëri të lirë e të përparuar. Me anë të saj synohej largimi i pushtesit osman nga trojet shqiptare dhe krijimi i një shteti të pavarur dhe etnik shqiptar. Për realizimin e këtij qëllimi ishte e nevojshme që krahas luftës së armatosur kundër pushtesit osman, të bëhej edhe arsimimi i rinisë shqiptare, tek e cila duhej të formësohej ndërgjegjja kombëtare. Kjo për faktin se vetëm si e tillë ajo mund të vihej në shërbim të çlirimit të atdheut. Mirëpo, zhvillimi i arsimit në gjuhën shqipe, sikurse më parë, edhe në fillim të shek. XX përballej me vështirësi të shumta. Ndërsa Perandoria Osmane njohu disa kombe në Ballkan, si bullgarët, serbët, grekët, të cilët kishin pasur vazhdimisht mbështetjen e Fuqive të Mëdha, e sidomos të Rusisë, shqiptarëve jo vetëm që u mungoi mbështetja e ndonjëres Fuqi të Madhe, por të drejtat e tyre kombëtare iu nëpërkëmbën edhe nga vetë Perandoria Osmane. Porta e Lartë vazhdonte t'i personifikonte shqiptarët sipas përkatësisë së tyre fetare. Kështu, shqiptarët e fesë myslimane janë quajtur "*myslim millet*" dhe regjistroheshin në dokumentet osmane si turq. Shqiptarët ortodoksë janë konsideruar pjesëtarë të "*rum milletit*", pra konsideroheshin grekë. Organet statistikore të Perandorisë Osmane përdornin në buletinet e tyre vjetore (salnametë) edhe rubrikën "*katolik-*

milet”, në të cilën përfshiheshin popujt e ndryshëm të këtij besimi, përfshirë edhe shqiptarët katolikë¹.

Në çerekun e fundit të shek. XIX, Lëvizja Kombëtare Shqiptare arriti një nivel më të lartë zhvillimi, duke u udhëhequr, në atë kohë, nga një qendër e vetme drejtuese. Nëpërmjet rezolutave, përkujtesave e thirrjeve kjo Lëvizje kërkonte nga qeveria osmane njohjen e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare dhe futjen e saj në shkollat e vendit. Kërkesa të tilla iu parashtruan Perandorisë Osmane edhe nga shoqëritë e mërgimit. Veçanërisht thirrja që lëshuan më 1 janar 1898 të gjitha shoqëritë atdhetare të mërgimit, të cilat kërkonin autonominë administrative të Shqipërisë me një qeveri shqiptare, me gjuhë zyrtare shqipe, me kishë e shkollë shqiptare. Kështu edhe ata kontribuan që Lëvizja Kombëtare Shqiptare të ecte në rrugë të drejtë².

Duke mos i njohur shqiptarët si kombësi të veçantë, për rrjedhojë, Porta e Lartë, krahas mohimit të drejtës së shkollimit në gjuhën shqipe, u mohonte atyre edhe të drejtën e botimit të librave, gazetave dhe të revistave. Në këtë kuadër qeveria osmane shtoi terrorin dhe mori masa të egra kundër arsimimit shqip dhe përhapjes së librave shqipe. Në qershor të vitit 1902, me dekretin e sulltan Abdyl Hamidit II u mbyll shkolla e djemve në Korçë³. Ky akt përbënte një dëshmi të qartë se Perandoria Osmane nuk kishte ndërmend të lejonte përhapjen e gjuhës dhe arsimimin e rinisë shqiptare në gjuhën e tyre amtare. Në këto kushte Lëvizja Arsimore Shqiptare duhej të kapërcente vështirësi të mëdha, për të fituar të drejtat për botime e arsimim në gjuhën shqipe, të drejta këto që u ishin njohur popujve të tjerë fqinjë, sllavë e grek.

Si rezultat i këmbënguljes së vazhdueshme të atdhetarëve shqiptarë, ndikimit të Lidhjes së Prizrenit, punës së palodhshme të shoqërive

¹ Jashar Rexhepagiq, *Shkollat dhe arësimi në Kosovë nga fundi i shek. XVIII gjer më 1918*, në: “Kosova”- “Kosovo”, Nr. 1, Prishtinë-Priština, 1972, f. 109; Hysni Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit (1909-1912)*, Tiranë, 2004, f. 41-42; *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, vëll. I, Tiranë, 2003, f. 172.

² Siri Shaplo, *Nga historiku i zhvillimit të arsimit në Shqipëri*, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 1975 f. 8.

³ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, botim i Akademisë së Shkencave, Instituti i Historisë, “Toena”, Tiranë, 2002, f. 351; Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare*, Libri 1, Prishtinë, 2004, f. 101; Nexhat Abazi, *Zhvillimi i arsimit, i shkollave dhe i mendimit pedagogjik shqiptar në Maqedoni (1830-1912)*, Tetovë, 1997, f. 127; S. Shaplo, *vep. e përm.*, f. 15.

kulturore dhe të intelektualëve shqiptarë, si dhe një vargu kryengritjesh-nga fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX, filluan krahas me numrin gjithnjë e më të madh të shkollave në gjuhën turke, greke, serbe etj., të hapen shkolla e të botohen libra edhe në gjuhën shqipe⁴. Mirëpo, duhet theksuar se edhe ato pak shkolla shqipe shpesh mbylleshin nga autoritetet osmane, sikurse edhe botimi i librave në gjuhën shqipe ndeshte në vështirësi të mëdha.

Ndryshimet politike që ndodhën në Stamboll, si rezultat i ngadhënjimit të Revolucionit Xhonturk në vitin 1908, u pasqyruan edhe në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Xhonturqit para se të merrnin pushtetin, vazhdimisht kishin deklaruar se ata ishin për respektimin e lirisë, të barazisë dhe të drejtësisë për të gjithë popujt e Perandorisë. Shqiptarët si përkrahësit më të rëndësishëm të xhonturqve⁵ shpresuan se në rrethana të reja, kur turqit e rinj kishin marrë pushtetin, nuk do të hasnin në pengesa për sa i përket hapjes së shkollave e të botimeve në gjuhën shqipe, e sidomos të teksteve shkollore. Prandaj disa muaj pas fitores së revolucionit, në nëntor të vitit 1908, në Manastir u mbajt Kongresi i Alfabetit të Gjuhës Shqipe. Në atë Kongres, i cili kishte karakter kulturor dhe rëndësi politike, u tubuan intelektualët shqiptarë⁶, të cilët kishin për synim të përpilonin një alfabet unik, i cili do të përdorej nga të gjithë shqiptarët. Përveç seancave të hapura që iu kushtuan çështjes së alfabetit, u mbajtën edhe seanca të fshehta, në të cilat u diskutuan rrethanat politike në Shqipëri. Për rrjedhojë, rezultuan 18 kërkesa që përfaqësojnë përkrahësit me kërkesat e mëparshme për autonominë e Shqipërisë⁷. Mirëpo, xhonturqit nuk i mbajtën premtimet e tyre. Ata filluan të ndjekin një politikë qendërsuese (centralizuese)⁸, ashtu si edhe regjimi i mëparshëm. Ky veprim i zhgënjeu shqiptarët, ashtu si edhe popujt tjerë të nënshtruar të Perandorisë Osmane.

⁴ R. Abdyli, *vep. e përm.*, f. 107-111.

⁵ *Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë* (më tej: *AIH*); *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSt.A,PA,A*); Fondi: Vj.19-8-838. Raport i konsullit von Kviatkovski, më 20 gusht 1909, mbi një bisedë me Fazil pashën dhe Fuad bej Toptanin.

⁶ R. Abdyli, *vep. e përm.*, f. 128; Jashar Rexhepagiq, *Zhvillimi i arsimit dhe sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*, Prishtinë, 1970, f. 211.

⁷ R. Abdyli, *vep. e përm.*, f. 125.

⁸ *Historia e arsimit dhe e mendimit ...*, f. 172-173.

Librat dhe tekstet shkollore në gjuhën shqipe botoheshin pothuajse tërësisht jashtë vendit, sepse atje atdhetarët shqiptarë kishin më tepër liri veprimi. Tekstet shkollore, të botuara nga fillimi i shek. XX në Bukuresht e në Sofje, dërgoheshin në Shqipëri përmes rrjetit të organizuar të atdhetarëve shqiptarë. Ato shërbenin si një ndihmesë e madhe për nxënësit e shkollave shqipe që punonin ilegalisht në disa qytete të Shqipërisë, që para vitit 1887⁹.

Në këto kushte një rol të rëndësishëm në zhvillimin e arsimit e të shkollës shqipe do të luajnë shkollat fetare të financuara nga Austro-Hungaria. Këto shkolla, në pjesën më të madhe të tyre, kanë vepruar në territoret shqiptare të Veriut dhe të Verilindjes, në të cilat mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe.

Vjena si mbrojtëse e besimtarëve dhe në këtë kuadër edhe e klerit katolikë në Perandorinë Osmane, kishte depërtuar prej kohësh në Shqipërinë e Veriut. Ajo vepronte në marrëveshje me Vatikanin, duke dhënë ndihma të gjithanshme për çështje fetare e mbajtje shkollash, të cilat i drejtonte kleri katolik, kryesisht shqiptarë. Kështu elementit katolik shqiptar iu lejua nga Perandoria Osmane të hapte shkollat e veta fetare, ku gjuha shqipe mësohej si mjet për t'i shërbyer edukatës fetare¹⁰.

Nga mesi i shek. XIX fillon të rritet interesimi i Perandorisë Austro-Hungareze për çështjen shqiptare në përgjithësi, e për shkollat shqipe në veçanti. Perandoria danubiane ishte në rivalitet me Perandorinë Ruse për dominim në Gadishullin Ballkanik. Shtetet sllave të Ballkanit, si: Serbia, Bullgaria dhe Mali i Zi, si shtete sllave dhe Greqia që kishte lidhje fetare me Rusinë, e shihnin Perandorinë e carëve si një vëlla të madh, pasi kjo e fundit vazhdimisht ishte treguar si mbrojtëse e vendosur e interesave të këtyre shteteve, për të mbrojtur kështu edhe interesat e saja strategjike. Kjo binte ndesh me interesat austro-hungareze në Ballkan. Kjo perandori, e cila shtrihej në pjesën Perëndimore të Ballkanit, synonte gjithashtu të zgjeronte sferën e ndikimit të saj në pjesën qendrore e jugore të këtij Gadishulli. Për t'ia arritur këtij qëllimi, ajo duhej të fitonte simpatinë të paktën të një populli që jetonte në këto territore e që nuk ishte nën sferën e ndikimit rus. I vetmi popull që mund të ishte aleat besnik i Vjenës dhe që njëkohësisht do të ishte barrierë ndaj zgjerimit të

⁹ *Po aty*, 147-149; R. Abdyl, *vep. e përm.*, 99-101; S. Shaplllo, *vep. e përm.*, f. 10, 13.

¹⁰ S. Shaplllo, *vep. e përm.*, f. 15-16.

mëtejshëm rus në Ballkan, ishte populli shqiptar. Për Austro-Hungarinë “... *Shqipëria dhe shqiptarët, si popull josllav në Ballkan, ishin një sferë e natyrshme interesash*”¹¹.

Në lidhje me çështjen shqiptare, Perandoria Austriake (nga viti 1867 Austro-Hungaria), në raport me Fuqitë e tjera të Mëdha, kishte pozita më të favorshme që ia siguronte asaj *Kultusprotektorati*. Të drejtën e *Kultusprotektoratit* mbi popullsinë katolike shqiptare, ajo e kishte siguruar në bazë të disa marrëveshjeve që kishte nënshkruar me Perandorinë Osmane. Që nga paqja e Silvatorokut (1615), Austrisë iu njoh protektorati mbi klerin katolik të Perandorisë Osmane¹². Sigurisht në atë kohë, ky zotim i Perandorisë Osmane ishte formal, sepse ajo ishte akoma mjaft e fuqishme dhe as që mendonte ta vinte në jetë këtë pikë të marrëveshjes që cenonte sovranitetin e saj mbi territoret e banuara nga popullsia katolike brenda territoreve të saj.

Marrëveshja e Silvatorokut ishte vetëm fillimi, sepse të drejtën e mbrojtëses së kultit Austria do ta forconte me marrëveshjet e mëvonshme, që do të nënshkruaj me Portën e Lartë. Zotimi që kishte dhënë Perandoria Osmane në vitin 1615, do të hyjë në një fazë të re pas disfatave që pësoi ajo në luftërat kundër Ruisë dhe Austrisë, të cilat pas traktatit të Karllovacit (1699) shënojnë edhe kthesën e fillimit të rënies së Perandorisë së sulltanëve. Traktati në fjalë i jepte Austrisë të drejtën të interesohej për popullsinë katolike të Perandorisë Osmane¹³. Këto të drejta do të forcohen me Traktatin e Pozharevacit të vitit 1718¹⁴ dhe të Beogradit të vitit 1739, si dhe në “*Letrat patente*” të lëshuara nga sulltani, sipas të cilave “*Austria trashëgoi nga Venediku të drejtën e*

¹¹ Karl Buchberger, *Vjetët e mija në Shqipëri*, në: “Studime historike”, nr. 4, Tiranë, 1972, f. 143.

¹² Krahaso me: Zef Prela, *Mbi politikën austro-ungare në Shqipëri në çerekun e fundit të shek. XIX*, në: “Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës”, Seria e Shkencave Shoqërore, Nr. 1, Tiranë, 1960, f. 183; Po ai, *Problemi shqiptar dhe politika austro-hungareze (1897-1912)*, në: “Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”, (Përmbledhje studimesh kushtuar 50-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë), Tiranë, 1962, f. 102.

¹³ Z. Prela, *Mbi politikën austro-ungare...*, f. 183-184; K. Buchberger, *art. i cit.*, f. 144.

¹⁴ Mikel Prenushi, *Vështrim historik mbi gjendjen dhe zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe dhe të huaj në Shkodrën e shekullit XIX*, në: “Studime historike”, nr. 3, Tiranë, 1974. Shih për këtë edhe referencën 7 në f. 67; K. Buchberger, *art. i cit.*, f. 144.

mbrojtjes së Vendeve të Shenjta dhe të drejtën e paraqitjes së ipeshkëve katolikë të Rumelisë". Në këtë kuadër përfshihej edhe Shqipëria¹⁵. Paqja e Svishtovës* e vitit 1791, që u nënshkrua pas luftës që Perandoria Osmane kishte zhvilluar me Rusinë e Austrinë, e detyronte Portën e Lartë, në artikullin e XII të këtij Traktati, të pranonte dhe të konfirmonte të gjitha privilegjet e akorduara Perandorisë Austriake, në Traktatin e Beogradit (në art. IX) si dhe në dokumentet e tjera të lëshuara nga autoritetet osmane¹⁶.

Nga viti 1837, Kuria Romane ia kalon perandorit të Austrisë të drejtën e mbrojtjes së katolikëve shqiptarë, çka shënoi forcimin e ndikimit dhe të interesimit të Perandorisë Danubiane për Shqipërinë¹⁷.

Interesimi i Austrisë për Shqipërinë do të shfaqet hapur duke filluar nga mesi i viteve 70^{të} të shek. XIX. Në marrëveshjen e dy perandorëve, perandorit austro-hungarez, Franc Jozefit, me perandorin rus, Aleksandrit II, arritur në Rajhshtat (1876), Ministri i Punëve të Jashtme të Vjenës, Andrashi, me gjithë kundërshtimin e heshtur të Ministrit të Punëve të Jashtme të Rusisë, Gorçakovit, kërkoi që *Shqipëria të formohej si një shtet autonom*, për çka nuk kundërshtoi pala ruse. Ndonëse, Vjena synonte që duke formuar një shtet autonom shqiptar, të pengonte zgjerimin sllav drejt Ballkanit Perëndimor dhe njëkohësisht të fitonte simpatinë e popullit shqiptar. Megjithëkëtë ky traktat kishte rëndësi politike, sepse për herë të parë u pranua nga dy Fuqi të Mëdha të kohës krijimi i shteti autonom shqiptar¹⁸. Andrashi, që ishte njëkohësisht edhe nismëtari i planit të zgjerimit në Ballkan të Austro-Hungarisë drejt Lindjes, ndër të tjera do të shprehej: "*Objektivi i politikës sonë synon që të sigurojë për një kohë të gjatë ndikimin tonë në gjysmën perëndimore të Ballkanit*"¹⁹.

¹⁵ Z. Prela, *Mbi politikën ...*, f. 184; shih edhe: Po ai, *Problemi shqiptar ...*, f. 105.

* Svishtova - qytet në Bullgarinë Verilindore.

¹⁶ Z. Prela, *Mbi politikën...*, f. 184; shih edhe: Jov. N. Tomić, *Austro-Bugarska i arbanasko pitane*, Beograd, 1913, s. 22.

¹⁷ Z. Prela, *Mbi politikën...*, f. 184.

¹⁸ *Po aty*, f. 185; *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, Prizren, 2001.

¹⁹ Z. Prela, *Mbi politikën...*, f. 190-191.

Interesimi i Austro-Hungarisë për arsimin shqip (1908-1909)

Interesimi i Perandorisë Austro-Hungareze për shkollat në Shqipëri, daton nga mesi i shek. XIX. Qendrat e para mësimore që financoheshin nga vetë qytetarët shkodranë, funksiononin privatisht deri në vitin 1855, kur tregtarët shkodranë dhe kleri i lartë, duke parë se mësuesit nuk i plotësonin kërkesat e kohës, filluan të interesohen për të sjellë nga jashtë mësues më të përgatitur. Kështu, me ndërmjetësimin e konsullit austriak në Shkodër, u thirrën në atë qytet mësues, të cilët filluan punë në vitin shkollor 1855-1856. Pra në këto shkolla mësimi zhvillohej fillimisht në gjuhë të huaj. Austria doli jo vetëm si mbrojtëse politike e këtyre shkollave por i ndihmoi ato edhe financiarisht²⁰. Ky ishte hapi i parë konkret që ndërmori qeveria e Vjenës për financimin e shkollave, në Shqipëri. Po në vitin 1855, qeveria austriake u interesua për ngritjen e Seminarit në Shkodër.

Në një udhëzim të vitit 1846*, për një inspektor krahinor shkollash, bëhet i qartë interesimi i drejtpërdrejt i qeverisë austriake për organizimin e shkollave në gjuhën italiane në Shqipërinë Veriore e bregdetare, ashtu sikurse dhe në krahinat tjera të Ballkanit Verior e Perëndimor që ishin nën mbrojtjen austriake²¹.

Shkolla e parë ku fillon mësimi i gjuhës shqipe, e që ishte nën përkujdesjen e qeverisë austriake, ishte Shkolla Françeskane e Shkodrës**. Më 1861 u hap në Shkodër Shkolla e Fretërve (Françeskanë). Kjo ishte shkolla e parë që njihet “*me të cilën zën fill mësimi i gjuhës shqipe*”²². Nga viti i themelimit të saj, në të dhanë mësim tre klerikë françeskanë, të huaj, At Rozario, Ludoviko e Tomaso, njohës të mirë të

²⁰ M. Prenushi, *art. i cit.*, f. 67.

* Është për t'u vënë në dukje se ky përbën dokumentin më të vjetër austriak që njohim me të dhëna për arsimin.

²¹ Po aty.

** Austro-Hungaria që nga viti 1855 kishte filluar të financonte shkolla në Shqipëri. Por, siç duket, në ato shkolla mësimi zhvillohej në gjuhën italiane. Prandaj, si shkollë e parë ku fillon zhvillimi i mësimin në gjuhën shqipe konsiderohet Shkolla Françeskane.

²² Fehime Pipa, *Nji shekull Shkollë Shqipe (1861-1961)*, “Shêjzat”, Romë, 1962, f. 3; M. Prenushi, *art. i cit.*, f. 70; shih edhe: P. Donat Kurti, O.F.M., *Vepra kulture e elementit katolik në Shqypni*, “Hylli i Dritës”, Shkodër, 1935.

gjuhës shqipe²³. Në shkollat e tjera, që ishin të pakta në numër, mësimi zhvillohej në gjuhë të huaj, në të cilat gjuha shqipe mësohej fshehurazi ose nuk mësohej fare²⁴.

Austro-Hungaria, megjithëse vazhdoi të mbante marrëdhënie të mira me Perandorinë Osmane edhe në fillim të shek. XX, ishte e vetëdijshme se kësaj perandorie i kishte ardhur fundi dhe se nuk do të ishte e largët dita kur asaj do t'i duhet të largohet nga pjesa e mbetur Juglindore e Evropës, pra edhe nga tokat shqiptare. Në një letër që ministri i jashtëm austro-hungarez, Goluhovski, i dërgonte ambasadorit të tij në Stamboll Kalise (Calise) në shkurt të vitit 1897, theksonte që në fillim se *status quo*-ja e Perandorisë Osmane ishte vërtetë “*garancia*” më e mirë për Austro-Hungarinë, por tatëpjeta e Perandorisë së sulltanëve ishte tashmë kaq e qartë sa që nuk mund të rrihej më duarkryq në pritje të ngjarjeve²⁵. Prandaj Vjena filloi t'i kushtojë rëndësi gjithnjë e më shumë çështjes shqiptare, e sidomos hapjes dhe funksionimit të shkollave shqipe. Që në vitet e fundit të shek. XIX, në Ministrinë e Jashtme austro-hungareze do të diskutohet çështja e shkollës dhe e gjuhës shqipe. Në Ministrinë e Jashtme austro-hungareze problemet e gjuhës shqipe u diskutuan dhe u rrahën me një zell dhe interes të jashtëzakonshëm, “*tue fillue prej Ministririt të Jashtëm deri te shefat mâ të vegjël edhe pse kjo mund t'i duket njeriut e pabesueshme, në radhët e Ministrisë së Jashtme u morën masat e duhuna filologjike*”²⁶.

Në Ministrinë e Jashtme perandorake e mbretërore, gjatë diskutimeve për çështjen shqiptare u arrit në përfundimin se më e rëndësishme ishte hapja dhe përkrahja e shkollave, si dhe botimi i librave në gjuhën shqipe. Në këtë mënyrë u mendua se do të ndihmohej ngritja e vetëdijes kombëtare shqiptare²⁷, element shumë i rëndësishëm që do t'u ndihmonte shqiptarëve të përparonin më tej si komb. Në kuadër të këtij angazhimi, në Ministrinë e Jashtme të Vjenës: “...në Nandorin e vjetit

²³ Uran Asllani, *Studentët shqiptarë në Austri dhe kontributi i tyre për shtetin shqiptar*, Tiranë, 2000, f. 61.

²⁴ *Historia e Popullit...*, f. 350-351.

²⁵ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare*, Tiranë, 2003, f. 46-47.

²⁶ Robert Schwanke, *Roli i Austro-Hungarisë në Kongresin e Manastirit në vjetin 1908*, në: “Përpyjekja jonë”- e përkohshme fetare e kulturore, vol. II, No. 3, New York, December 1971, f. 85.

²⁷ *Historia e Popullit...*, f. 30.

1896 u zhvilluen bisedime interministeriale me të cilat do të mund të perkrahesh dhe të vehesh në lvizje zhvillimi komtár në Shqipni”. Në këto bisedime të zhvilluara në Vjenë, ku u diskutua edhe gjendja e shkollave shqipe, të cilës iu dha një rëndësi e veçantë, do të shqyrtohet edhe çështja e botimit dhe pajisjes së shkollave me libra shqip. Në Ministrinë e Jashtme “... u kujdesuen, në radhë të parë me botue dhe me pajisë me libra të nevojshme shkollat katolike shqiptare”²⁸.

Deri në vitin 1902, në shkollat e financuara nga Perandoria Austro-Hungareze, mësimi zhvillohej edhe në gjuhën italiane “kurse nga ajo kohë në të gjitha shkollat austriake u hoq gjuha italishte dhe u zëvendësua me gjuhën amëtare”²⁹.

Shkollat e financuara nga Austro-Hungaria ishin të organizuara mirë dhe drejtoreshin prej klerit katolik shqiptar. Qeveria e Vjenës nuk i kontrollonte shpesh këto shkolla. Në ndonjë rast të veçantë, konsujt austro-hungarezë bënin ndonjë vizitë nëpër to³⁰.

Austro-Hungaria e filloi veprimtarinë arsimore ndër shqiptarët katolikë, sepse atje gëzonte liri veprimi, çka ia siguronte asaj *Kultusprotektorati*. Në shkollat austro-hungareze numri i nxënësve erdhi duke u rritur vazhdimisht, sepse në to jepnin mësim mësues të ngritur profesionalisht. Njëkohësisht meqë këto shkolla ishin nën mbrojtjen e një Fuqie të Madhe, prindërit shqiptarë i dërgonin fëmijët e tyre në to, pa pasur frikë se do të ndiqeshin nga organet e pushtetit osman.

Edhe pse veprimtaria e shkollave katolike në Shqipëri ishte e kufizuar në shkollim fillor profesional, ku funksioni parësor i tyre ishte mbrojtja dhe kultivimi i fesë katolike, megjithatë, ato prapë se prapë luajtën rol të rëndësishëm në ngritjen arsimore të një pjese të rinjve shqiptarë dhe në kultivimin e gjuhës shqipe, shkrimit dhe të traditës kulturore shqiptare, si dhe në ruajtjen e lidhjeve tradicionale të natyrshme e me përvojë shekullore të popullit shqiptar me qytetërimin perëndimor. Me të drejtë studiuesi Hajrullah Koliqi arrin në përfundimin se për të ruajtur interesat dhe ndikimin e saj në trevat shqiptare, Vjena veç të tjerave, po i vishte shkollat e saja katolike gjithnjë e më shumë me

²⁸ R. Schwanke, *vep. e për.*, f. 85.

* **Kultusprotektorat** (gjermanisht)- protektorat i kultit.

²⁹ U. Asllani, *vep. e për.*, f. 63.

³⁰ M. Prenushi, *art. i cit.*, f. 67-68.

“*rrobën kombëtare duke i shtuar orët e mësimin të gjuhës shqipe*”³¹. Pra, Austro-Hungaria zhvilloi një politikë në shërbim të arsimit e kulturës shqiptare: inkurajoi dhe mbështeti financiarisht shoqëri kulturore, gazeta e revista në gjuhën shqipe; ndihmoi në botimin e librave në gjuhën shqipe. Ajo e ndihmoi Lëvizjen Arsimore dhe Kulturore në Shqipëri edhe me ndërtimin e shkollave si dhe përgatitjen e kuadrit arsimor shqiptar në shkollat austriake, si në: Villach, Linc, Grac³², Insbruk³³, Klagenfurt³⁴, Mydling³⁵, Vjenë³⁶ etj.

Përderisa shkollat në gjuhën turke, greke, bullgare, serbe, italiane e gjermane që ishin ngritur prej kohësh në Shqipëri dhe mbështeteshin financiarisht nga shtetet përkatëse e u shërbenin qëllimeve të tyre propagandistike, Austro-Hungaria, në dallim nga to, u tregua shumë më liberale³⁷. Ajo lejoi pjesërisht ose tërësisht mësimin e gjuhës shqipe, megjithëse kështu kultivonte gjithnjë e më shumë synimet e saj politike ndaj Shqipërisë së Veriut³⁸.

Pas aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës nga Austro-Hungaria (më 1908), ajo i kushtoi një kujdes të veçantë zgjerimit të bazës së Kultusprotektoratit austriak në Shqipëri. Masat e ndryshme që duhej të shërbenin për këtë qëllim, ishin: përgatitja e klerit katolik, financimi i urdhrave katolike dhe institucioneve fetaro-kulturore si dhe shkollave të ndihmuara financiarisht prej tyre, organizimi i peshkopatave³⁹, përfshirë edhe ndihmesën financiare për organet e shtypit në gjuhën shqipe⁴⁰, për

³¹ Hajrullah Koliqi, *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*, Prishtinë, 2002, f. 183.

³² U. Asllani, *vep. e përm.*, f. 39.

³³ *Po aty; AIH*, Vj. 18-13-1311. Njoftim i drejtorit të Konviktit në Insbruk për shefin e sektorit f. Volf, më 19 tetor 1910.

³⁴ H. Myzyri, *vep. e përm.*, f. 63; Stavro Skëndi, *Zgjimi kombëtar shqiptar: 1878-1912*, Tiranë, 2000, f. 241.

³⁵ *HHSSt.A,PA,A*, Vj. 17-1-138. Raport i Institutit Arsimor të Ekonomisë Bujqësore në Mydling, për këshilltarin ekonomik zotin Shlahter, më 5 nëntor 1907.

³⁶ S. Skëndi, *vep. e përm.*, f. 241.

³⁷ R. Abdyl, *vep. e përm.*, f. 106; shih edhe: Charles dhe Barbara Jelavich, *Themelimi i shteteve kombëtare të Ballkanit 1804-1920*, Tiranë, 2004, f. 210.

³⁸ R. Abdyl, *vep. e përm.*, f. 106.

³⁹ Z. Prela, *Problemi shqiptar ...*, f. 106.

⁴⁰ *Historia e Popullit...*, f. 344-345.

personalitete të shquara shqiptare, si: Dervish Hima*, Faik Konica, Shahin Kolonja, Gjergj Fishta, Nikollë Ivanaj, Ibrahim Temo, Gjergj Pekmezi, Gjergj Qiriaz, Fehim Zavalani etj.

Në manifestin e nëntorit të vitit 1908, që Austro-Hungaria ua dërgonte nga Shkupi shoqatave shqiptare dhe personaliteteve të shquara të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare⁴¹, jepeshin arsyet e aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës, veprim ndaj të cilit shqiptarët përgjithësisht kishin mbajtur qëndrim mospajtues, duke u udhëhequr nga përvoja e hidhur e aneksimit të territoreve shqiptare nga shtetet fqinje, si pasojë e vendimeve të Kongresit të Berlinit. Në dokument thuhej se Perandoria Austro-Hungareze prej kohësh ishte angazhuar për përhapjen e gjuhës dhe të shkollave shqipe. Në fund të “Manifestit”, që u publikua edhe në gazetën “Vardar” të Shkupit, thuhej se Austro-Hungaria ishte përpjekur që të zgjidhej çështja e gjuhës shqipe dhe të bëhej një gjuhë për të gjithë shqiptarët, se hapja e shkollave shqipe të projektuara për këtë qëllim ishte programuar prej kohësh nga Monarkia Austro-Hungareze⁴².

Vjena nxiste dhe përkrahte zhvillimin arsimor të shqiptarëve dhe çdo përpjekje që bëhej për zhvillimin e tyre kulturor⁴³. Madje, qeveria austro-hungareze nëpërmjet ambasadorit të saj në Stamboll, Pallaviçini, në vitin 1908, kërkoi nga Porta e Lartë “*të fuste mësimin e gjuhës shqipe në të gjitha shkollat shtetërore të viseve shqiptare*”⁴⁴. Me këto veprime qeveria vjeneze, siç mund të shihet, synonte të siguronte epërsinë në çështjen shqiptare, e cila po merrte rëndësi gjithnjë e më të madhe.

Hovi që mori Lëvizja Arsimore Shqiptare pas triumfit të Revolucionit Xhonturk, nuk qe jetëgjatë. Xhonturqit sapo konsoliduan pushtetin e tyre filluan, që nga viti 1909 të kufizonin përdorimin e gjuhës shqipe dhe të mbyllnin shkollat ku mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe. Në vend të mësimave dhe të librave shkollor të shkruar me alfabet latin, xhonturqit angazhoheshin për shkrim me shkronja arabe.

Të ndodhur përballë vështirësive, që u vunë në dukje më sipër, për t’i ardhur në ndihmë Lëvizjes Arsimore Shqiptare, atdhetarët tanë u

* Dervish Hima ishte pseudonim i Ibrahim Naxhiut, redaktorit të gazetës “Shqiptari” (Arnaud).

⁴¹ R. Abdyl, *vep. e përm.*, f. 140.

⁴² Gazeta “Vardar”, Skopje, br.13, 23.XI.1908, f. 2, (cituar sipas J. Rexhepagiq, *art. i cit.*, f. 228).

⁴³ *Historia e Popullit...*, f. 261.

⁴⁴ *Po aty*, f. 387.

përpoqën të shfrytëzonin aq sa ishte e mundur shkollat e çelura nga Perandoria Austro-Hungareze, të cilat Perandoria Osmane, e shtrënguar nga traktatet e përmendura më sipër, i lejonte prej kohësh të funksiononin.

Në shkollat katolike të financuara nga Vjena, përdorimi i gjuhës shqipe dhe i alfabetit latin bëhej pa ndonjë problem, pasi ato ishin nën mbrojtjen e kësaj Fuqie të Madhe, çka ishte në përputhje me interesat e Lëvizjes Arsimore Shqiptare.

Në një raport nga Shkupi, që konsulli austro-hungarez i dërgonte Ministrin të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, baronit Alois fon Erental, më 19 janar të vitit 1908, jepen të dhëna mbi frekuentimin e mësimit nga nxënësit e shkollave të Shkupit, të cilat ishin nën mbrojtjen e qeverisë perandorake e mbretërore*. Në raport gjithashtu thuhej se gjendja në *shkollën famulltare katolike* shqiptare në Shkup kishte mbetur pothuajse e pandryshuar, në krahasim me atë të një viti më parë. “Aktualisht- thuhej në vijim- ajo ka 43 (në vitin e kaluar 44) nxënëse të regjistruar, 23 djem dhe 20 vajza”. Ndonëse mësuesit bënë përpjekje të vazhdueshme që nxënësit të ishin të rregullt në ndjekjen e mësimeve, ata nuk po arrinin suksesin e dëshiruar. Ndjekja e mësimeve në shkollë në fakt është si më parë, jo e rregullt. Përpjekjet e mësuesve që të arrihej një efekt i rregullt i ndjekjes së mësimit në shkollë, dështojnë në indiferentizmin e prindërve të tyre⁴⁵. Në atë kohë, në këtë shkollë jepte mësim mësuesi Gjon Kajtazi⁴⁶, një atdhetar i shquar nga Shkupi, i cili ishte dhe drejtor i saj dhe dallohej për një tolerancë ndërftare midis shqiptarëve⁴⁷.

Numri i nxënësve që ndiqnin mësimin në shkollën e mësipërme ishte shumë më i madh në krahasim me numrin e nxënësve që ndiqnin mësimet në shkollën italiane të Shkupit. Shkolla italiane kishte gjithsej 23 nxënës, prej të cilëve vetëm 3 ishin shqiptarë katolikë, kurse pjesën tjetër pothuajse tërësisht e përbënin fëmijët katolikë të “*kolonisë levantine (lindore- F. R.)*”⁴⁸.

* Kështu quhej Qeveria e Austro-Hungarisë.

⁴⁵ *HHSt.A,PA,A*, Vj. 18-7-761. Raport nr. 10, i konsullit austro-hungarez nga Shkupi, Rappaport drejtuar Vjenës, më 19 janarit 1908.

⁴⁶ *Po aty*, Vj. 18-5-518. Raport nr. 153, që Lukes ia dërgonte nga Shkupi Erentalit, më 25 shtator 1908.

⁴⁷ Gazeta “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 1908.

⁴⁸ *HHSt.A,PA,A*, Vj. 18-7-761.

Shkolla tjetër që funksiononte në Shkup, e që mbahej nga Austro-Hungaria, ishte *Shkolla e Hekurudhës*. Ajo ishte shkollë gjermane, ku nxënësit përvetësonin njohuri më të thelluara se sa në shkollën famulltare. Numri i nxënësve që ndiqnin mësimin në atë shkollë, në vitin 1908, gati ishte dyfishuar në krahasim me vitin paraprak. Ajo “*paraqet një shtesë frekuence të konsiderueshme nga 29 vitin e shkuar në 51 (29 djem dhe 22 vajza) sot në mes tyre janë pesë fëmijë shqiptarë*”. Nxënësit shqiptarë synonin që duke ndjekur mësimin në këtë shkollë, të mësonin gjuhë të huaja, mbasi kanë krye shkollën famulltare në Shkollën e Hekurudhës “*aspirojnë që të përvetësojnë në një kulturë relativisht më të lartë domethënë të mësojnë gjuhë të huaja*”⁴⁹.

Në një njoftim që konsulli i përgjithshëm austro-hungarez, Kral, i dërgonte Vjenës, nga Shkodra, më 25 shtator të vitit 1909, del se Perandoria Austro-Hungareze financonte në Shkodër këto institucione arsimore: Kopshti i fëmijëve të servitinëve, që frekuentohej nga 453 nxënës; Shkolla françeskane, në të cilën ndiqnin mësimin 170 nxënës; Shkolla elementare e jezuitëve, me 219 nxënës; Shkolla stigmatine e vajzave, me 306 nxënëse; Shkolla tregtare e jezuitëve, me 49 nxënës; Shtëpia jetimore austro-hungareze për djem, me 30 nxënës, dhe Internati i malësorëve, me 25 nxënës⁵⁰.

Nga të dhënat e mësipërme, del se vetëm në Shkodër, qeveria austro-hungareze u mundësonte 1252 nxënësve shqiptarë ndjekjen e mësimëve në shkollat e financuara prej saj.

Në atë kohë, Austro-Hungaria ishte në rivalitet të ashpër me qeverinë italiane për dominim në Shqipëri, pasi secila prej tyre përpiqej të fitonte simpatinë e shqiptarëve dhe kështu të shrinte ndikimin e vet në territoret shqiptare. Prandaj, ashtu si qeveria e Vjenës edhe ajo e Romës kishin ngritur shkollat (institucionet) e tyre në territoret shqiptare dhe sidomos në Shkodër, e cila ishte qendër e katolikëve në Shqipëri. Numri i nxënësve që frekuenton shkollat (institutet) arsimore italiane ishte shumë më i vogël se numri i atyre të instituteve austro-hungareze. Në vitin 1908, përfaqësues të konsullatës austro-hungareze në Shkodër kishin vizituar Institutet italiane të këtij qyteti. Sipas të dhënave të tyre, numri i nxënësve që frekuentonin këto institute ishte më i vogël në krahasim me

⁴⁹ *Po aty*.

⁵⁰ *Po aty*, Vj. 19-3-303. Raport i Kralit nga Shkodra drejtuar Erentalit, më 25 shtator 1909.

numrin e nxënësve të instituteve austro-hungareze. Sipas njoftimit të 25 shtatorit të vitit 1909: 1. Kopshti i fëmijëve kishte 120 nxënës; 2. Shkolla e djemve, 110 nxënës; 3. Shkolla fillore për vajza, 119 nxënës; 4. Shkolla teknike-tregtare, 33 nxënës; 5. Shkolla e artizanatit, 34 nxënës dhe 6. Shtëpia jetimore e vajzave, 64 nxënës⁵¹. Kështu, numri i përgjithshëm i nxënësve të shkollave (instituteve) të financuara nga qeveria e Romës kapte shifrën prej 480 nxënësish, që do të thotë se ishte për 772 nxënës më i vogël se numri i nxënësve të shkollave austro-hungareze⁵².

Në një njoftim tjetër që i dërgohej Vjenës nga Shkodra më 15 maj të vitit 1910, jepej një përshkrim i hollësishëm i shkollave shqiptare, për vitin shkollor 1909-1910, të financuara nga Perandoria Austro-Hungareze. Në të jepen të dhëna për mësuesit e këtyre shkollave, për arsimimin e tyre, si dhe numrin e klasave të secilës shkollë. Sipas këtij njoftimi del se qeveria e Vjenës gjatë vitit shkollor 1909-1910 financonte këto shkolla në trojet shqiptare:

Shkodër

Kolegji i “Françesk Saverit”, që drejtohej nga jezuitët; Shkolla fillore e fretënve për djem; Shkolla fillore Stigmatine për vajza në Shkodër; Shkolla Stigmatine për vajza në Shirokë; Shkolla e djemve në Shirokë, Shkolla e djemve në Dajç-Bunë, Shkolla e djemve në Bushat, Shkolla e djemve në Juban, Shkolla e djemve në Selcë⁵³.

Shkup

Shkolla shqipe e famullisë. Kjo shkollë kishte tre klasë për djem dhe dy klasë për vajza, si dhe një kopsht fëmijësh, Shkolla e Hekurudhës në Shkup kishte katër klasë dhe një kopsht fëmijësh. Shkolla katolike e famullisë në Ferizaj, me tre klasa, Shkolla shqipe katolike e famullisë në Stubëll*, me tre klasa⁵⁴.

⁵¹ *Po aty*, Vj. 19-3-303, Shkodër, 25 shtator 1909.

⁵² *Po aty*.

⁵³ *Po aty*, Vj. 20-14-1431. Njoftim nga Shkodra i 15 majit 1910.

* Në dokumente përmenden gjithashtu edhe shkollat e Janjevës dhe Letnicës, mirëpo në to mësimi zhvillohej edhe në gjuhën sllave (kroate). Sipas prof. Rexhepagiqit në vitin 1908 drejtori i shkollës së Janjevës ishte Pal Gjergja, shqiptar i Zarës, kurse mësues i klasës së parë ishte Ivan Berisha nga Janjeva. Sipas katalogut të shkollës, në ato vite nxënësit kanë mësuar edhe gjuhën shqipe (J. Rexhepagiq, *vep. e cit.*, f. 228; J. Rexhepagiq, *art. i cit.*, f. 210).

⁵⁴ *HHSTA, PA, A.*, Vj. 20-14-1431. Njoftim nga Shkodra i 15 majit 1910.

Prizren

Shkolla katolike e djemve kishte tre klasa me pesë ndarje. Shkolla katolike për vajza në Prizren kishte një klasë me tre ndarje dhe një kopsht fëmijësh. Shkolla katolike në Gjakovë, një klasë me tre ndarje⁵⁵. Shkolla e Pejës ishte vendosur në një lokal pranë shkollës katolike. Në të fëmijët, meshkuj dhe femra i ndiqnin mësimet ndaras⁵⁶.

Durrës

Shkolla fillore katolike për vajza e motrave zemërdhimbshme me një klasë. Shkolla fillore katolike për djem në Rrëshen, me dy klasa, Shkolla katolike për djem në Milot.

Dioqeza e Sapës

Shkolla e djemve në Hajmel me një klasë dhe tre ndarje. Shkolla e djemve në Dajç-Zadrimë kishte një klasë me tre ndarje.

Dioqeza e Lezhës

Shkolla e djemve dhe e vajzave e motrave zemërdhimbshme në Kallmet.

Abacia e Mirditës

Shkolla e djemve në Orosh, një klasë me tre ndarje. Shkolla e djemve në Kashnjet kishte një klasë me tre ndarje. Shkolla e djemve në Spaç, një klasë me tre ndarje⁵⁷.

Gjithashtu në Shkodër, Austro-Hungaria financonte edhe Kopshtin e fëmijëve servite dhe Shtëpinë e djemve jetimë. Në të parin, punonin motra e urdhrit, Suora Maria Petroviq, e cila ishte edhe eprore, pesë motra të tjera urdhëri dhe tri ndihmëse. Kurse, në Shtëpinë e djemve jetimë drejtor ishte Br. Bernardin Dillingen, i cili kishte kryer Shkollën Pedagogjike në Bregens, Br. Altman Fellingner, prefekt, që kishte të kryer seminarin për mësues në Shtrebersdorf. Djemtë jetimë frekuentonin shkollën e fretënve⁵⁸.

⁵⁵ *Po aty.*

⁵⁶ J. Rexhepagiq, *vep. e përm.* f. 153, 234.

⁵⁷ *HHSt.A,PA,A*, Vj. 20-14-1431. Njoftim nga Shkodra i 15 majit 1910.

⁵⁸ *Po aty.*

Krahas shkollave të sipërpërmendura, Austro-Hungaria ka financuar edhe shkolla të tjera. Shkolla private katolike kanë vepruar edhe në trevën e Lumës⁵⁹, në Tiranë⁶⁰, Durrës, Vlorë⁶¹, Zym, Zllokuqan⁶², Ohër⁶³. Një shkollë në trevën e Hotit (në Traboin), shkollën e lazaristëve të Manastirit⁶⁴, një Ushtrimore (Foshnjore) “Fridrik Frabel” në Prizren, e themeluar në vitin 1907, por që filloi me punë nga 1 shtatori i 1908-ës, ku u dallua si mësuese Mikelangjela Qoba. Këtë Ushtrimore e ndiqnin fëmijët (djem e vajza) të moshës tre deri në gjashtëvjeçare. Çdo vit numri i nxënësve ishte 30-50 fëmijë⁶⁵. Vetëm në qytetin e Shkodrës, që nga fillimi i shek. XX, kishte shtatë shkolla austro-hungareze, kurse në gjithë vilajetin e Shkodrës kishte 21 të tilla; në vilajetin e Kosovës kishte tetë shkolla austro-hungareze, pa përmendur këtu shkollat katolike të Janjevës e Letnicës, ku në përgjithësi mësimi është zhvilluar edhe në gjuhën sllave, kurse në vilajetin e Manastirit ishin tre të tilla (në sanxhakun e Manastirit)⁶⁶. Edhe në vendbanime të tjera shqiptare kanë ekzistuar shkolla, ku disa klerikë, krahas mësimit fetar, përpiqeshin t’i mësonin fëmijët dhe të rriturit që të lexojnë dhe të shkruajnë. Në fshatrat Shestan dhe Brisk, afër Tivarit, që në gjysmën e parë të shekullit XIX kanë ekzistuar shkolla për fëmijët shqiptarë⁶⁷, si dhe në vetë qytetin e Tivarit, ku Austro-Hungaria, që nga fillimi i viteve 60^{te} të shek. XIX kishte ndërtuar një shkollë me konvikt, për nxënësit shqiptarë⁶⁸.

Nga të dhënat e mësipërme shihet qartë se veprimtaria arsimore e Austro-Hungarisë ishte e përqendruar më tepër në vilajetin e Shkodrës dhe sidomos në vetë qytetin e Shkodrës, për shkak se pjesa më e madhe e popullsisë katolike shqiptare ishte e përqendruar në atë vilajet, dhe në vetë qytetin e Shkodrës ndodhej konsullata kryesore austro-hungareze për territoret shqiptare. Financimi i shkollave shqiptare do të realizohej pikërisht nëpërmjet kësaj konsullate. Pjesa më e madhe e këtyre

⁵⁹ *Historia e Popullit ...*, f. 301.

⁶⁰ *Po aty*, f. 301, 351.

⁶¹ S. Skëndi, *vep. e përm.*, f. 238.

⁶² J. Rexhepagiq, *art. i cit.*, f. 215.

⁶³ *Po aty*, f.187.

⁶⁴ J. Rexhepagiq, *vep. e përm.*, f. 153.

⁶⁵ *Po aty*, f. 237-238.

⁶⁶ *Historia e Popullit...*, f. 301.

⁶⁷ J. Rexhepagiq, *vep. e përm.*, f. 154.

⁶⁸ *Po aty*, f. 154-155.

shkollave ishin fetare dhe administroheshin nga institucionet katolike, dhe vetëm një pjesë e tyre ishin laike (fillore) ose profesionale. Në disa nga këto të fundit e frekuentonin mësimin edhe fëmijë shqiptarë myslimanë⁶⁹. Këto shkolla punonin sipas programeve austriake⁷⁰.

Në mungesë të shkollave kombëtare shqiptare, udhëheqësit e Lëvizjes sonë Arsimore do të angazhohen për të shfrytëzuar shkollat e mbajtura nga qeveria e Vjenës. Në të gjitha shkollat austro-hungareze në Shqipëri, mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe, pasi ato gëzonin liri të plotë veprimi. Porta e Lartë, në bazë të marrëveshjeve të mëparshme me Vjenën (shih më lartë), nuk kishte mundësi të ndërhynte. Kjo u mundësonte fëmijëve katolikë shqiptarë, në dallim nga bashkëkombësit e tyre myslimanë dhe ortodoksë, të arsimoheshin në gjuhën e tyre amtare. Në shkollat e tjera të financuara nga të huajt, si ato: greke, turke, serbe, italiane etj., mësimi zhvillohej në gjuhë të huaj, kurse gjuha shqipe ishte e ndaluar, pasi qeveritë përkatëse kishin synime asimiluese ndaj shqiptarëve. Me të drejtë Charls dhe Barbara Jelavich konstatojnë se ndryshe nga institucionet myslimane dhe ortodokse, shkollat katolike i zhvillonin mësimet në gjuhën vendase⁷¹. Kjo përbënte një përparësi të madhe për ndërgjegjësimin e nxënësve shqiptarë të këtyre shkollave me ide kombëtare.

Për të shfrytëzuar sa më mirë mundësinë që u jepnin shkollat austro-hungareze, atdhetarët shqiptarë do të bëjnë përpjekje të vazhdueshme që krahas fëmijëve katolikë, në shkollat katolike të ndiqnin mësimin edhe fëmijët e vëllezërve të tyre myslimanë. Kështu, në një takim të mbajtur në Selanik, me rastin e themelimit të klubit të Selanikut ku merrte pjesë edhe mësuesi i shkollës së famullisë së Shkupit, Gjon Kajtazi, u diskutua dhe u pa e nevojshme që në shkollën e Shkupit të ndiqnin mësimin edhe fëmijët myslimanë, krahas vëllezërve të tyre katolikë. Mit'hat Frashëri, që sapo u zgjodh kryetar i klubit të Selanikut, në bashkëbisedimin me Gjon Kajtazin vuri në dukje: “*nevojën për ngritjen kulturore dhe ekonomike të shqiptarëve*”, çka mund të realizohej, sipas tij, vetëm me ngritjen e shkollave kombëtare⁷². Mirëpo,

⁶⁹ *Historia e Popullit...*, f. 301; R. Schwanke, *art. i cit.*, f. 88; J. Rexhepagiq, *vep. e përm.*, f. 160; Po ai, *art. i cit.*, f. 187.

⁷⁰ J. Rexhepagiq, *vep. e përm.*, f. 152.

⁷¹ Ch. & B. Jelavich, *vep. e përm.*, f. 210.

⁷² *HHSI.A,PA,A*, Vj. 18-5-518. Informacion sekret, nr. 153, që Lukes ia dërgonte nga Shkupi, Alois fon Erentalit, më 25 shtatorit 1908.

përderisa nuk ekzistonin “*shkolla të tilla interkonfesionale (kombëtare-F. R.)*” shkollat shqipe katolike, të cilat vepronin pranë famullive, të viheshin në shërbim të këtij qëllimi “*duke pranuar muhamedan shqiptar në shkollat e famullive*”. Sipas këtij atdhetari, në këtë drejtim Shkupi do të shënonte fillimin për t’u bërë shembull për shkollat tjera. I vetëdijshëm se te një pjesë e shqiptarëve myslimanë ishin të forta ndjenjat fetare, Mit’hat Frashëri në një takim që pati me konsullin e përgjithshëm austro-hungarez Rappaport, vinte në dukje se: “*...në rastin se mohamedanëve shqiptarë nuk do t’i pëlqehet vendi i shkollës në Shkup*”, pasi si shkollë e famullisë ajo gjendej në oborin pranë kishës katolike dhe për këtë arsye myslimanët fëmijët e tyre nuk do t’i dërgonin aty, ai rekomandonte “*transferimin e shkollës jashtë oborrit të kishës*”⁷³.

Sipas konsullit të përgjithshëm austro-hungarez të Selanikut, Rappaport, i cili kishte zhvilluar paraprakisht bisedime me famullitarin e Shkupit dhe drejtuesit e klubit të “Bashkimi” të atij qyteti, të dyja palët do ta përshëndesnin, siç thuhej, me simpati “*pranimin e mohamedanëve shqiptarë në shkollën katolike*”, të Shkupit. Gjithnjë sipas tij, nxënësit myslimanë nuk do të ndiqnin “*mësimin e besimit*”. Rappaport mendonte se projekti ishte i realizueshëm, sepse nuk mungonte lokali, por vetëm se shkolla “*duhet të rrethohet me një mur...dhe të bëhet një hyrje e veçantë në oborin e shkollës*”, çka teknikisht mund të realizohej lehtësisht⁷⁴. Nexhip Draga, anëtar dhe Hamdi beu, kryetar i klubit të Shkupit, shpresonin, thuhet në relacion “*se do t’i bëjnë për vete kolegët e tyre liberalë, që ata t’i dërgonin fëmijët e tyre në shkollë, për të ndjekur të tjerët shembullin e tyre*”⁷⁵.

Rëndësia politike e pranimin të shqiptarëve myslimanë në shkollat katolike shqiptare të famullive, të cilat ndodhen nën protektoratin e qeverisë perandorake e mbretërore ka për të rënë në sy “*se përkrahja e kombësisë shqiptare nga ana jonë (e Austro-Hungarisë-F. R.)*”, do të dëshmojë “*se çështja është kapur për rrënjë dhe për këtë arsye ajo do ta jap frutin*”⁷⁶. Veçimi i shkollave prej famullive do të mundësonte themelimin e shkollave fillore shqipe të pavarura dhe në këtë mënyrë do të vihet baza e një zhvillimi kulturor. Ndjekja e shkollave katolike nga nxënësit myslimanë “*pavarësisht nga mbështetja që do të kishte*

⁷³ Po aty.

⁷⁴ Po aty.

⁷⁵ Po aty.

⁷⁶ Po aty.

monarkia në popullatën shqiptare”, do të shënonte edhe fillimin e “*inaugurimit të një politike paralizuese të ndikimit të serboizmit në Vilajetin e Kosovës*”⁷⁷.

Në disa nga shkollat e mbajtura nga Austro-Hungaria do të ndiqnin mësimin edhe fëmijët shqiptarë myslimanë dhe ortodoks. Kështu, në shkollën e Iballës në Pukë, ku punonte si mësues Kolë Zezaj, mësonin fëmijët e të dy besimeve, në shkollën e Prizrenit mësimin e “*ndiqnin edhe nxënës myslimanë*”, kurse shkolla e Tiranës “*filloi të vijohej nga nxënësit e të trija besimeve*”⁷⁸. Gjithashtu, bejlerët myslimanë i “*dërgojshin fëmijët e tyre ndër shkollat katolike*”.

Nga mesi i vitit 1909, bejlerët e Shqipërisë së Mesme Fuad bej Toptani dhe i vëllai i tij Fazil pasha do të ndërmerrnin një aksion për të siguruar mbështetjen e qeverisë vjeneze për hapjen e disa shkollave fillore në Tiranë, në Malësinë e saj dhe në Mat. Në funksion të këtij qëllimi, dy bejlerët toptanas do të takohen me konsullin austro-hungarez, në Durrës, von Kviatkovski, në gusht të vitit 1909, nga i cili kërkuan që qeveria austro-hungareze t’u akordonte një ndihmë financiare “*për realizimin e këtij aksioni kulturor*”⁷⁹. Në raport, gjithashtu, vihet në dukje se para disa muajve kryekonsulli i Italisë në Shkodër propozoi mjetet e nevojshme për ndërtimin e shkollave shqipe. Por, ata mendonin se “*Italia ka qëllim në radhë të parë të përhapë gjuhën italishte*” në Shqipëri. Prandaj, për të mos i lejuar qeverisë së Romës të realizonte qëllimet e saj, ata do të ndërmerrnin një udhëtim në Vjenë, me qëllim që të bindeshin “*nëse qeveria austro-hungareze tregon akoma të njëjtin interes për zhvillimin nacional të vendit të tyre si më përpara*”⁸⁰.

Përveç kërkesës për të ndihmuar hapjen e shkollave, Fuad beu dhe Fazil pasha mendonin që gjatë vizitës së tyre në Vjenë, të kërkonin nga Ballhausplatz* edhe: dërgimin e një mjeku kirurg në Tiranë, si hap përgatitor për hapjen e një spitali; dërgimin e disa studentëve myslimanë në institutet e Austro-Hungarisë; ndihmë financiare për një ndërmarrje

⁷⁷ *Po aty*.

⁷⁸ *Historia e arsimit...*, f. 166, 137, 161; Shih edhe: U. Asllani, *vep. e përm.*, f. 62.

⁷⁹ *HHSSt.A,PA,A*, Vj. 19-8-838. Raport, pa nr., i konsullit von Kviatkovski dërguar Vjenës më 20 gusht 1909.

⁸⁰ *Po aty*.

* Kështu quhej Ministria e Punëve të Jashtme e Austro-Hungarisë.

gazetash, të cilën Fazil pasha mendonte ta themelonte në Vjenë ose Trieste dhe në përgjithësi më tepër ndihmë morale për shqiptarët⁸¹.

Në funksion të kërkesave të mësipërme të vëllezërve Toptani, në një urdhëresë që qeveria vjeneze i dërgonte nënkonsullit të saj në Durrës, Halla, theksonte se: megjithëse në përgjithësi ne nuk duam t'i përkrahim përpjekjet kulturore të shqiptarëve myslimanë afërsisht po në atë mënyrë siç i kemi përkrahur ato të bashkëkombësve të tyre katolik, pasi shqiptarët myslimanë ishin *“jashtë kuadrit të protektoratit të kultit”* dhe se *“mund të konsideroheshin fare lehtë nga regjimi i tanishëm (i Stambollit- F.R.) si një ndërhyrje në punët e brendshme të shtetit turk”*. Megjithatë, qeveria austro-hungareze nuk donte ta refuzonte tërësisht kërkesën e mësipërme, duke u nisur nga interesat e saj për të mos humbur simpatinë e dy bejlerëve toptanas, të cilët kishin mjaft ndikim tek bashkëkombësit e tyre në Shqipërinë e Mesme. Gjithashtu, rivalja kryesore e Austro-Hungarisë në Shqipëri, Italia ishte shumë aktive në politikën e saj, për të përhapur ndikimin në brigjet lindore të Adriatikut. Kryekonsulli i saj, në Shkodër, kishte shprehur gatishmërinë e vendit të tij për të realizuar kërkesat e mësipërme. Prandaj, më tej në urdhëresë thuhet: *“Prapseprap, ne mendojm se në rastin e parashtruar, për arsye të shumta, të mos refuzojmë krejtësisht kërkesën e lartpërmendur të bejlerëve në fjalë”*⁸². Pasi Fazil pasha kishte premtuar se ndihma nuk do të përdorej për çështje politike, atij i ishte dhënë një shumë e caktuar koronash. Paratë e marra nga qeveria e Vjenës do të përdreshin për hapjen e shkollave në Tiranë, Malësi si dhe në Mat, dhe emërimin e një mjeku⁸³. Dy bejlerët në fjalë, në takimet me përfaqësuesit austro-hungarez kishin shprehur dyshimin se mos Vjena kishte ndryshuar qëndrimin e saj ndaj shqiptarëve, prandaj në fund të urdhëresës thuhet: *“Simpatitë tona për shqiptarët nuk kanë ndryshuar”*⁸⁴.

Në një raport, që zëvendëskonsulli Halla i dërgonte nga Durrësi ministrit të tij të Punëve të Jashtme, kontit fon Erental, më 26 maj të vitit 1910, parashtronte dëftesën e Fuad bej Toptanit për marrjen e 15.650 frangave, të cilat qeveria e Vjenës ia kishte dhënë si ndihmë për hapjen e

⁸¹ *Po aty.*

⁸² *Po aty*, Vj. 19-2-235. Urdhëresë tepër sekrete e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë dërguar nënkonsullit të saj në Durrës, Halla, nr. 3110, më 27 shtator 1909.

⁸³ *Po aty.*

⁸⁴ *Po aty.*

shkollave dhe realizimin e projekteve tjera, të planifikuara nga Fuad beu dhe vëllai i tij, Fazil Pasha⁸⁵.

Kërkesa për ndihmë nga qeveria vjeneze ka pasur edhe nga shkollat ortodokse, që deri atëherë financoheshin nga qeveria greke. Një shkollë e tillë ishte edhe ajo e Elbasanit, e cila në fillim të vitit 1909 kishte 80 nxënës si dhe 60 djem që ndiqnin shkollën e natës. Ndjenjat kombëtare ndër ortodoksët e Elbasanit kanë qenë gjithmonë mjaft të fuqishme dhe kjo binte ndesh me synimet helenizuese të qeverisë greke. Për ta shkëputur shkollën nga ndikimi grek, arkimandriti patër Germanosi, në emër të komunitetit ortodoks të Elbasanit, në një takim që pati me konsullin austro-hungarez, në Durrës, Halla, e pyeste atë nëse qeveria austro-hungareze do të ishte në gjendje t'i akordonte shkollës së komunitetit ortodoks të atjeshëm një *“subvencion vjetor prej 150 lirash turke”*, në rast se asaj do t'i hiqesh subvencioni me të njëjtën *“shumë që po merrë deri sot nga qeveria greke”*⁸⁶. Dhe nuk kaloi shumë kohë kur qeveria helene ndërpreu ndihmesën jo vetëm për atë por për të gjitha shkollat ortodokse të sanxhakut të Elbasanit. Në një raport që Halla i dërgonte nga Durrësi, ministrit të tij të jashtëm baronit fon Erental, më 26 mars të vitit 1909, e njoftonte këtë të fundit për vendimin e qeverisë greke për ndërprerjen e subvencionit si dhe kërkesën e përsëritur nga komuniteti ortodoks i Elbasanit për ndihmesë nga Austro-Hungaria⁸⁷.

Pas kërkesave të shumta që komuniteti ortodoks i Elbasanit, me arkimandrin patër Germanosin në krye, i kishin drejtuar Vjenës, siç duket më në fund, Ballhausplatzi, akordoi *“një ndihmë financiare për komunitetin ortodoks shqiptar të Elbasanit për të përkrahur përpjekjet e tyre kombëtare shqiptare në lëmin kultural”*⁸⁸.

⁸⁵ *Po aty*, Vj. 20-1-144. Raport i nënkonsullit Halla për ministrin e Jashtëm, kontin fon Erental, më 26 maj të vitit 1910.

⁸⁶ *Po aty*, Vj. 19-2-202. Raporti nr. 29, që Halla i dërgonte nga Durrësi, baronit fon Erental, më 14 mars 1909.

⁸⁷ *Po aty*, Vj. 19-2-203. Raporti nr. 30, që nënkonsulli Halla i dërgonte nga Durrësi, baronit fon Erental, më 26 mars 1909.

⁸⁸ *Po aty*, Vj. 19-2-206. Telegrami nr. 78, që Halla i dërgonte nga Durrësi Erentalit, më 22 nëntor 1909.

Financimi i qeverisë austro-hungareze për botimin e teksteve shkollore në gjuhën shqipe (1908-1909)

Mbarëvajtja e procesit edukativo-arsimor në shkolla është e lidhur ngushtë me pajisjen e nxënësve me mjete mësimore. Në shkollat e mbajtura nga Austro-Hungaria, tekstet dhe mjetet mësimore janë siguruar nga vetë qeveria e Vjenës. Në një njoftim, që Ministria e Jashtme i dërgonte konsullatës së saj të përgjithshme në Shkodër, në fund të janarit të vitit 1908, e njoftonte këtë të fundit se për nevojat e shkollave katolike shqiptare kishte nisur për në Shkodër 40 ekzemplarë të librit të leximit shqip, pjesa e parë, dhe 30 ekzemplarë të librit të leximit italisht, pjesa e tretë⁸⁹.

Në një raport që i drejtohej Vjenës nga Shkodra më 27 korrik 1908, viheshin në dukje nevojat për tekste mësimore, të shkollave të financuara nga Austro-Hungaria në rrethin administrativ të Shkodrës. Konsulli Lejahnec i dërgonte Ministrisë së Jashtme një listë me tekstet e nevojshme për shkollat e sipërpërmendura, për vitin shkollor 1908-1909: 350 ekzemplarë libra leximi shqip pjesa e I-rë; 140 ekzemplarë libra leximi shqip pjesa e II-të; 50 libra të Historisë së shenjtë⁹⁰. Gjithashtu në raport theksohej se nevoja për libra të tjerë shqip si *“libra leximi pjesa III, katekizmi pjesa III, libra aritmetike pjesa II do të plotësohen nga rezervat që kemi këtu”*⁹¹.

Në korrik të vitit 1908, kryetari i shoqërisë “Dija”*, Dr. Gjergj Pekmezi, i drejtonte një lutje Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, për t’i dhënë një ndihmë prej 300 koronave për botimin e një libri të vogël me poezi në gjuhën shqipe, të përgatitur nga Hil Mosi, dhe botimin e një libri të Robinson Cruzoe-së të përkthyer në gjuhën shqipe nga Kost Paftali. Këto libra ishin cilësuar si shumë të mirë nga Gjergj Pekmezi, prandaj ai kërkonte ndihmën e sipërpërmendur për botimin e

⁸⁹ *Po aty*, Vj. 18-9-937. Njoftim nr. 99267/6, i Ministrisë së Jashtme Austro-Hungareze për konsullatën e saj të përgjithshme në Shkodër, më 30 janar të vitit 1908.

⁹⁰ *Po aty*, Vj. 18-9-945. Raport nr. 432/2 nga Shkodra për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, më 27 korrik 1908.

⁹¹ *Po aty*.

* Shoqëria “Dija” u themelua në Vjenë nga Dr. Gjergj Pekmezi, në vitin 1904.

tyre⁹². Kjo ndihmë u miratua nga Ministria e Jashtme austro-hungareze, për çka Dr. Gjergj Pekmezi parashtronte dëftesën për marrjen e 300 koronave, për botimin e librave në fjalë⁹³.

Në shkurtin e vitit 1909, Ministria e Financave e Austro-Hungarisë i akordonte një ndihmë prej 1000 frangash, Eqrem bej Vlorës, për botimin e veprës “Nga Berati dhe nga Tomori”⁹⁴.

Në një raport tjetër që i dërgohej Vjenës po nga Shkodra, më 13 maj 1909, jepej lista me librat ekzistues dhe ato të nevojshëm për vitin shkollor 1909-1910⁹⁵:

Titulli	Kërkohen	Ekzistojnë	Propozimi për 1909-1910
Libër leximi pjesa I-rë	325	109	216
Libër leximi pjesa II-të	205	43	162
Libër leximi pjesa III-të	195	101	94
Katekizmi pjesa I-rë	320	122	198
Katekizmi pjesa II-të	265	31	234
Katekizmi pjesa III-të	80	304	-
Libër aritmetike pjesa I-rë	245	34	211
Histori e shenjtë	375	-	375

Për shkollat e Rrëshenit dhe të Milotit që ishin nën administrimin e konsullatës së Durrësit, në maj të vitit 1909, nga Vjena u dërguan 100 ekzemplarë të katekizmit shqip, pjesa e parë⁹⁶.

Në gushtin e vitit 1909, konsulli i përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Lejhanec, i raportonte Ministrisë së Jashtme se i kishte dorëzuar Patër Gjergj Fishtës, shumë prej 160 koronave, si paradhënie, për botimin e veprës së tij “Pika Voestet”⁹⁷. Marrjen e kësaj ndihme e

⁹² *HHSStA,PA,A*, Vj. 18-9-952. Kërkesë e Dr. Gjergj Pekmezit drejtuar Ministrisë së Jashtme, më 12 korrik 1908.

⁹³ *Po aty*.

⁹⁴ *Po aty*, Vj. 19-4-429. Njoftim sekret, nr. 599, i Ministrisë së Financave të Austro-Hungarisë për konsullin e saj të përgjithshëm në Shkodër Kviatkovski, më 17 shkurt 1909.

⁹⁵ *Po aty*, Vj.19-11-1150. Raport nr. 283/2, nga Shkodra për MPJ në Vjenë, më 13 maj 1909.

⁹⁶ *Po aty*, Vj. 20-12-1219. Njoftim nr. 28278/2, nga Vjena për konsullatën e Durrësit, më 9 maj 1909.

⁹⁷ *Po aty*, Vj. 19-4-424. Raport nr. 159, i konsullit Lejhanec, nga Shkodra, për kontin Erental, më 27 dhjetor 1909.

vërtetonte edhe vetë Gj. Fishta, me një dëftesë që ia dërgonte Ministrisë së Jashtme⁹⁸.

* * *

Në përpjekjet e tyre për afirmimin e çështjes shqiptare dhe zgjidhjen e saj, atdhetarët shqiptarë i kushtuan një rëndësi të veçantë edhe gjetjes së aleatëve të jashtëm të kësaj çështje. Ata ishin të vetëdijshëm se faktori i jashtëm ishte po aq i rëndësishëm sa edhe faktori i brendshëm. Nga Fuqitë e Mëdha evropiane të asaj kohe, aleatë i shqiptarëve dhe mbrojtës i idesë së një shteti shqiptar ishte Perandoria Austro-Hungareze, e cila shihte në realizimin e një ideje të tillë një pengesë për daljen e sllavëve në Adriatik. Qeveria e Vjenës duke parashikuar rënien e afërt të Perandorisë Osmane, filloi t'i nxiste dhe ndihmonte shqiptarët në përpjekjet e tyre për afirmimin kulturor, kombëtar e politik.

Politika arsimore që ndoqi Austro-Hungaria në Shqipëri, ishte mjaft e dobishme për popullin tonë. Shkollat austro-hungareze do të ndihmojnë sadopak në zbutjen e nevojave të popullit shqiptar për zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe. Këto shkolla që financoheshin nga qeveria austro-hungareze, ishin mjaft të përparuara për kohën. Ndjekja e mësimin në këto shkolla, në pjesën më të madhe të cilave punonin mësues të përgatitur në shkollat e Austro-Hungarisë, si: Hilë Mosi, Kol Kadheli, Ndue Paluca, Kolë Margjini⁹⁹ etj., të cilët ishin të një niveli të lartë për atë kohë, ishte një ndihmesë e rëndësishme për Lëvizjen tonë Arsimore.

Vjena, me të drejtë, deklaronte se kishte hapur shkollën e parë evropiane në Shqipëri, Kolegjin Saverian (Collegio Saveriano), e cila ishte shkollë e mesme e themeluar në Shkodër, që nga viti 1877¹⁰⁰. Austro-Hungaria krenohet se nga kjo shkollë kishin dalë shumë personalitete të shquara shqiptare, si: Faik Konica, Mati Logoreci, Luigj

⁹⁸ *Po aty*, Vj. 19-4-421. Dëftesë pa nr. e At Gjergj Fishtës, drejtuar Ministrisë së Jashtme austro-hungareze, më 12 gusht 1909.

⁹⁹ *Po aty*, f. 65.

¹⁰⁰ S. Skëndi, *vep. e përm.*, f. 128.

Bumçi, Luigj Gurakuqi*, Ernest Koliqi¹⁰¹, Imzot Dom Nikollë Kaçorri, Imzot Pashk Trokshi, Imzot Lazër Mjeda, Imzot Jak Serreqi¹⁰² etj.

Shumë nga këta personalitete, edhe pas mbarimit të shkollimit të tyre vazhduan të mbanin lidhje me qeverinë e Vjenës dhe dhanë kontribut të çmuar për historinë tonë kombëtare. Faik Konica, me ndihmën e Austro-Hungarisë, botoi për disa vjet revistën “*Albania*”*, fillimisht në Bruksel e pastaj në Londër. Në të u trajtuan tema të ndryshme me interes për çështjen kombëtare, ku demaskoheshin synimet antishqiptare fqinjëve tanë dhe të disa Fuqive të Mëdha. Mati Logoreci, Luigj Gurakuqi, Imzot Lazër Mjeda, Imzot Jak Serreqi etj., duke punuar si mësues, dhanë kontribut të madh për arsimimin e të rinjve shqiptarë. Imzot Dom Nikollë Kaçorri u emërua zëvendës-kryeministër i Qeverisë së parë shqiptare.

Në të vërtetë, patriotët shqiptarë, si Faik Konica, Dervish Hima, Luigj Gurakuqi, Dervish bej Biçaku, Mit’hat Frashëri etj., nuk bënë gjë tjetër, veçse u përpoqën të gjenin mënyrën më efikase, për të harmonizuar interesat e Perandorisë Austro-Hungareze në Adriatik me interesat e shqiptarëve dhe çështjes së tyre të pazgjidhur.

Për këto arsye, shqiptarët e besimit katolik ushqenin simpati të madhe për politikën e ndjekur nga Austro-Hungaria ndaj Shqipërisë, por edhe shqiptarët e besimit mysliman dhe ortodoks ushqenin simpati jo të vogël ndaj kësaj politike¹⁰³.

* Luigj Gurakuqi, u emërua drejtor i parë i Shkollës Normale të Elbasanit.

¹⁰¹ Zef Prela, *Problemi shqiptar dhe Kultusprotektorati austro-hungarez (fundi i shek.XIX- fillimi i shek. XX)*, në: “Studime Historike”, Nr. 3, Tiranë, 1965, f. 149.

¹⁰² *Diftime historijet permbi Kolegjen Papnore t’Shqypniis*, në: “Shtypshkroje t’Zojis Paperlyeme”, 1909, f. 88.

* Numri i parë i revistës “Albania”, doli më 25 mars të vitit 1897. Kjo revistë fillimisht u botua në Bruksel, kurse në vitet 1903-1909, në Londër. Ideator, botues dhe redaktor i saj ishte Faik Konica. Ajo botonte shkrime në gjuhën frengje, me karakter kombëtar dhe historik për çështjen shqiptare. Me këtë revistë bashkëpunuan edhe një varg shkrimtarësh të shquar, të kohës, si F. Shiroka, L. Gurakuqi, A. Z. Çajupi, F. S. Noli, H. Mosi etj. Moto e saj ishte: MPRON TË DREJTAT E POPULLIT SHQIPTAR.

Si pasojë e vështirësive financiare, Faik Konica do të detyrohet të kërkojë ndihmë nga jashtë për botimin e revistës. Prandaj, më 25 nëntor 1897, ai zhvilloi një takim me ministrin e Jashtëm të Perandorisë Austro-Hungareze, Baronin Golluhovski. Pas këtij takimi, ministri i përmendur, urdhëron ambasadën austro-hungareze në Bruksel, që të paguante shpenzimet e topografisë së revistës “Albania”.

Roli i revistës “Albania”, sipas gazetarit të shquar shqiptar, z. Blendi Fevziu, është i padiskutueshëm në shtypin shqiptar. Sipas tij, 25 marsi i 1897, kur doli

*S u m m a r y*ALBANIA IN THE POLICY OF THE AUSTRO-HUNGARY IN THE
BEGINNING OF THE 20TH CENTURY

One of main problems Albanians were facing in the beginning of the 20th century was the lack of education in their own native language. As a consequence, Albanians were ready to accept the assistance and attempts of any Power Nations that was willing to help in this field. The Viennese government while taking advantage of the *Cultus Protectorate* and at the same time securing the sympathy of the Albanian population opened several elementary schools and some secondary ones in Albania.

Albanian catholic schools, financed by the Viennese government, were expanded in one big part relatively of the Albanian lands where it stretched first from Tivary, in the north-west, in Peja to Zllokuqan in the north and continuing to Stubëll also Shkup in the north-east, in Tirana, Durrës, in the mid Albania. Within this precinct, a series of schools have operated which contributed greatly for the development of the Albanian language education. The Viennese government not only helped with the schooling and education of the new generation but also, in increasing the level of Albanian national awareness. Austro-Hungarian schools in Albania did serve as a strong base for further development of the national educational system after the declaration of the Independence.

Financial assistance, the Viennese government gave for the publication of the school books and also other writings in Albanian language constituted a valuable and big contribution for the development of the Albanian language and literature at that important period.

numri i parë i saj, mund të nënvizohet si dita e parë e gazetarisë moderne shqiptare. Ajo pati ndikim të madh në jetën politiko-patriotike, kulturore dhe gjuhësore shqiptare. Ajo ishte një ndërmarrje kolosale, me vlerë jo vetëm për kohën kur u botua dhe për historiografinë, por edhe për të ardhmen. Faik Konica, veç të tjerash ka një meritë të madhe edhe për pasurimin e gjuhës shqipe me terma të rinj, zëvendësimin e termave të huaja me terma të gjuhës shqipe etj. (Për më tepër shih: Blendi Fevziu, *Histori e shtypit shqiptar (1848-1996)*, Tiranë, 1996, f. 20-24, 117). Gjithë kjo ndërmarrje, do të kishte qenë e pamundur pa ndihmën financiare të qeverisë së Vjenës.

¹⁰³ U. Asllani, *vep. e për.*, f. 40.